




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Mitrovica Sever – Municipality of Mitrovica North



Kuvendi i Komunës

Nr. . Datë: 07/05/2025

Mitrovicë Veriore

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës Nr. 10-030/01-0007269/240 të datës 28.06.2024, Rregullores Komunale Nr. 02/223 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Transfereve, dhe Granteve, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore sjell këtë:

VENDIM

(Për Subvencionimin e një (1) hershëm të Fëmijëve me Nevoja të veçanta.)

1. Mbështetje financiare e një (1) hershme e Fëmijëve me Nevoja të veçanta.
2. Mbështetja financiare sipas pikës një (1) të këtij Vendimi është në shumën prej **500 €**.
3. Shuma e mjeteve për fëmijët të paguhet në llogarinë bankare të prindërve apo kujdestarit ligjor.
4. Mjetet financiare për subvencionimi e përfituesëve sipas Pikës 1 të këtij Vendimi do të sigurohen nga : Fondi Burimor 10;21;22. Kategoria ekonomike – Subvencione dhe Transfere 200 dhe Nënprogrami -Zyra e Kryetarit (16038).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zhvillim Ekonomik.

Dorëzohet:

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

1x1 Kryetarit të komunës, DBFZHE



Kryesues i K.K. të Mitrovicës së Veriut
Nedžad Ugljanin



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

REPUBLIKA E KOSOVES	REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E MITROVICES VERIORE	OPSTINA SEVERNA MITROVICA
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	10
Nr. Prot. on Prot. on Prot. on	10-030/01-0007306/25
Nr. Dated. Datum. Date	12.05.2025

Skupština opštine

Br.

Datum: 07/05/2025

Severna Mitrovica

Na osnovu Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj samoupravi, opštinskog statuta br. 10-030/01-0007269/240 od 28.06.2024, Opštinskom uredbom br. 02/223 o uslovima, kriterijumima i procedurama za dodelu subvencija i transfera i grantova, Skupština opštine Severna Mitrovica donosi sledeće:

ODLUKA

(Za (1) jednokratku subvenciju za decu sa posebnim potrebama.)

1. (1) Jednokratka finansijska za decu sa posebnim potrebama.
2. Finansijska podrška iz tačke jedan (1) ove odluke iznosi **500 €**.
3. Iznos sredstava za decu uplatiti na žiro račun roditelja ili zakonskog staratelja.
4. Finansijska sredstva za subvencionisanje korisnika iz tačke 1. ove odluke obezbediće: Resursni fond 10;21;22. Ekonomska kategorija – Subvencije i transferi 200 i Podprogram – Kancelarija gradonačelnika (16038).
5. Za sprovođenje ove Odluke odgovorni su Gradonačelnik, Predsedavajući Skupštine i Direkcija za budžet i finansije i ekonomski razvoj.

Dostaviti :

1x1 Predsedavajućeg skupštine

1x1 MALS-u

1x1 Arhivi

1x1 Gradonačelniku opštine, DBFER

Predsedavajući SO Severna Mitrovica

Nedžad Ugljanin





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Erden Atiq, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut Nedžad Ugljanin, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovicës së Veriut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Atiq,
I nderuar Kryesues z. Ugljanin,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimi nr.01-0007306/25, për subvencionimin e njëhershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta.

I miratuar me datë 12.05.2025

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 13.05.2025

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 19.05.2025

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Mitrovicës së Veriut, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Mitrovicës së Veriut, me anë të aktit administrativ komunal synon subvencionimin e njëhershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"). Po ashtu, është konsultuar dhe Ligji Nr.08/L-2332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Parimi i përgjithshëm i mishëruar në LMFPP është se çdo organizatë buxhetore, në shpenzimin të parashë publike, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të LMFPP-së, sikurse përcaktohet në nenin 3 të LMFPP-së.
4. Në përmbajtje të LMFPP-së, paratë publike përkufizohen si pasuri financiare ose para të cilat pranojnë, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e ndër-tjerash, organizatave buxhetore.

5. Ndërsa, në kontekst të shpenzimit të parashë publike, neni 17 i LMFP-së përcakton se shpenzimi i parashë publike nga organizatat buxhetore mund të bëhet vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe nga *fondet e ndarë dhe të alokuara* [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për vitin 2025 fiskal. Mirëpo, duke marrë parasysh se nuk dihet shuma e saktë për ndarje, obligohet komuna që brenda ndarjeve buxhetore të planifikuara me Ligjin e Buxhetit vjetor të bëjë edhe ndarjen e subvencioneve.
7. Komuna duhet që në çdo Vendim tjetër të nxjerrur të përcaktojë shumën totale të ndarjes së këtyre subvencioneve në mënyrë që Vlerësimi i Ligjshmërisë të bëhet në mënyrë të plotë.
8. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Mitrovicës së Veriut është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të njëjtit i konfirmohet ligjshmëria me kusht që komuna të bëjë ndarjen e subvencioneve brenda ndarjeve buxhetore të planifikuara me Ligjin e Buxhetit vjetor.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve